



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:206437

Datë: 04.10.2019

Numri i dokumentit: 00553646

P.nr.991/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari i vetëm Ilir Bytyqi, me asistentin Muedin Rexhepi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.H nga Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.2 lidhur neni 248 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1568-11/19 të datës 16.09.2019, në prani të përfaqësueses së akuzës-prokurores së shtetit Sebahate Sinani, të dëmtuarave H.H dhe V.H, si të akuzuarit N.H me mbrojtësin e tij me autorizim av. A.SH, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 30.09.2019 mori dhe publikisht shpalli, kurse me datën 04.10.2019 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: N.H i lindur më, me vendbanim në Rr. në Ferizaj, nga i ati H... dhe nëna E... e vajzërisë H..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar pa kurorë, prind i katër fëmijëve, gjendjes së mesme ekonomike, me vendqëndrim në, Komuna, Zvicër, posedon dokument identifikimi me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 06.09.2019, rreth orës 23:40 min, në rrugën, në Ferizaj, saktësisht në shtëpinë e tyre, i pandehuri me dashje ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarave-vajzave të tij H....dhe V.H, në atë mënyrë që me përdorimin e një mjeti të përshtatshëm për shkaktimin e

lëndimit të rëndë trupor-shkop druri me gjatësi rreth 1 metër, e godet të dëmtuarën H.H në pjesën e pasme të kokës përkatësisht në qafë e më pas vazhdon ta godas me shqelma e grushte në pjesë të ndryshme të trupit, pas kësaj godet edhe të dëmtuarën V.H po ashtu në pjesë të ndryshme të trupit me shqelma dhe grushte, ku si pasojë e këtyre goditjeve të dëmtuarat pësojnë lëndime të lehta trupore të përshkruara si në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 10.09.2019.

me këtë ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.2 lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69 të KPRK-së si dhe nenin 365 dhe 359 të KPRK –së, të akuzuarin N.H e

G J Y K O N

- **Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) Viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej 2 (dy) Vite, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm nuk kryen vepër tjetër penale.**
- **Në dënimin e shqiptuar si më lartë i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 06.09.2019 deri më datë 30.09.2019.**
- **Të dëmtuarat: H.H dhe V.H me vendbanim në rrugën në Ferizaj, nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore-juridike.**
- **Në bazë të nenit 450 par.1 dhe par.2 të KPPK-së, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë) si dhe shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore në shumën prej 20 Euro (njëzet), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.**
- **Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/,**

brenda afatit prej /30/ ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.1568-11/19 të datës 16.09.2019 ka ngarkuar të akuzuarin N.H, për veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 lidhur nënpar 3.2 lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridioksionin e sajë dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate, po ashtu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën ngarkohet i akuzuari gjykohet nga gjyqtar i vetëm gjykues.

Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar dhe publik me datë 30.09.2019, në të cilin shqyrtim kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Sebahate Sinani, të dëmtuarat H.H dhe V.H, i akuzuari N.H si dhe mbrojtësja e tij me autorizim av. A.SH.

Në fillim të shqyrtimit fillestar në mbështetje të nenit 245 par.2 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari në mënyrë të rregullt ka pranuar kopjen e aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Ferizaj si dhe ka konstatuar se janë plotësuar detyrimet lidhur me zbulimin e provave të parapara ë nenin 245 par.4 të KPPK-së.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

Pasi gjykata ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar ne tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 346 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit te shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar ne tërësi

aktakuzën, konform nenit 246 par.4 të KPPK-se i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari N.H me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, këtë sipas të gjitha pikave të sajë, se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimin të fajësisë duke shtuar se i vjen keq për këtë veprë penale, ndihet thellë i penduar, ka shfrytëzuar rastin t'i kërkojë falje publike të dëmtuarave-vajzave të tij, ka premtuar se nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme si dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptojë një dënim sa me të butë.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurorja e shtetit Sebahate Sinani duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqë ky pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i akuzuari e ka bërë vullnetarisht dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-se si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

E dëmtuara H.H në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike duke shtuar se raportet i kanë pas të mira dhe nuk kanë pas mosmarrëveshje më parë por që një kohë të shkurtë këto raporte janë dëmtuar pa ndonjë arsye të madhe, ka kërkuar nga i akuzuari-prindi i sajë që ai të deklarohet publikisht se raportet tona do të rregullohen sepse janë një familje dhe kërkojnë të jetojnë së bashku.

E dëmtuara V.H në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike duke shtuar se jetojnë në një bashkësi familjare, gjegjësisht në Kosovë jetojnë ajo, motra e sajë, vëllai dhe nëna, ndërsa babai i sajë në Zvicër dhe me atë personalisht asnjëherë nuk ka pas ndonjë mosmarrëveshje, prindi i sajë është mbajtës i familjes edhe për kundër faktit se edhe ajo me motrën e së punojnë.

Mbrojtësja e të akuzuarit N.H, av.A.SH me rastin e paraqitjes së mendimit të sajë lidhur me pranimin e fajësisë nga klienti i sajë ka theksuar se i propozon gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga klienti i sajë dhe të njëjtin pranim ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes dënimit, klienti i sajë kërkon falje publike dhe tërheqë deklarin e tij se nuk do ti pranoj vajzat e tij në shtëpi si dhe premtion se ai do të kujdeset për to dhe për tërë familjen siç ka bërë edhe deri më tani, ai për herë të parë gjendet para një situatë të tillë dhe se natën kritike nuk ka qenë nën ndikim të alkoolit po substanca narkotike dhe konsiderojmë se të gjitha këto shërbejnë si rrethana lehtësuese.

I akuzuari N.H lidhur me mendimin për pranimin e fajësisë ka deklaruar se në tërësi mbështet deklarin e mbrojtëses së tij, i vij keq për atë që ka ndodhur, publikisht u ka kërkuar falje vajzave të tij dhe premtion se veprime të tilla më nuk do të përsëris pasi raportet do ti kthejnë si në gjendjen e mëparshme.

Provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar dhe të gjeturat e gjykatës.

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së pasi i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari dhe pas konsultimeve të mjaftushme me mbrojtësen e tij, pranimi i fajit mbështetët në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: ekspertiza mjeko-ligjore e datës 10.09.2019, raporti i oficerit 2019-CF-1638 i datës 07.09.2019, deklarata e të dëmtuarës H.H e datës 09.09.2019, deklarata e të dëmtuarës V.H e datës 09.09.2019, deklarata e të akuzuarit N.H e datës 07.09.2019 si dhe të gjitha provat dhe shkresat tjera që gjenden në dosjen e lëndës.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e parashikuara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mundë të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin*

gjkues dhe pa mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të datës 19.03.2013).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.2 lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së, ashtu siç çshtë theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Matja dhe shqiptimi i dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, sjelljen e tij korrekte gjatë gjykimit, faktin se i akuzuari ka kërkuar falje publike, se nuk rezulton të jetë i dënuar me parë për ndonjë vepër penale dhe se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ndërsa sa u përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë rrethane rënduese veçse e vlerësoi peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, prandaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.2 nënpar. 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.991/19 datë 04.10.2019

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ilir Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.